

KOSOVA NË SFONDIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO - JUGOSLLAVE

1968 – 1981

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

ÇLIRIM LIMANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

STUDIME PASUNIVERSITARE - MASTER

Prishtinë, 2021

KOSOVA NË SFONDIN E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO - JUGOSLLAVE 1968 – 1981

Mentori: Prof. Dr. Bujar Dugolli

Studimi: “*Kosova në sfondin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1968-1981*”, ka për qëllim që përmes një objektiviteti shkencor të shtjellojë marrëdhëniet në mes të shtetit shqiptar dhe atij jugosllav në fusha të ndryshme, mirëpo të fokusuar gjithmonë në raport me Kosovën dhe veçanërisht në marrëdhëniet në mes të kësaj të fundit me Shqipërinë. Mbi zhvillimet e ndryshme që ndodhën gjatë kësaj periudhe e në theks të veçantë mbi bashkëpunimin në sfera të ndryshme në mes të Kosovës dhe Shqipërisë gjatë viteve 1970\80. Mirëpo, përveç bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë studimi do të jetë i fokusuar edhe mbi qëndrimin e Shqipërisë ndaj ngjarjeve të ndryshme që ndodhën në Kosovë, veçanërisht mbi ato për demonstratat e vitit 1968, demonstratat e vitit 1981 dhe vlerësimin e saj për Kushtetutën e vitit 1974.

Punimi është i ndarë në pesë krerë. Secili prej këtyre krerëve do të trajtojë në mënyrë të veçantë specifikat të cilat i përmban.

Kreu I: “*Kosova pas plenumit të Brionëve dhe demonstratat e vitit 1968*”. Këtu është trajtuar fillimisht Plenumi IV i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë të mbajtur më 1966, arsyeja se pse studimi fillon me këtë ngjarje është për shkak se pas këtij Plenumi nga udhëheqja bie Aleksandër Rankoviçi dhe në Kosovë fillojnë ndryshimet e para pozitive. E rrjedhën e këtyre ndryshimeve pozitive për Kosovën do ta vazhdojnë demonstratat e vitit 1968. Prandaj, këto të fundit zënë një vend të rëndësishëm në këtë studim dhe organizimi dhe mbajtja e tyre do të analizohen në mënyrë të detajuar. Këtu do të flitet edhe për qëndrimin e Shqipërisë ndaj mbajtjes së këtyre demonstratave dhe qëndrimin e kësaj të fundit ndaj kërkesave të demonstruesve. Ndërsa, në fund të këtij kreu do të paraqitet pasqyrimi i këtyre demonstratave në gazetën “*Rilindja*” dhe në shtypin e huaj.

Kreu II: “*Ndryshimet juridike dhe gjendja socio – ekonomike në Kosovë 1968-1980*”. Duke i marrë parasysh këto ndryshime karshi Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi pas rënies së A. Rankoviçit, në Kosovë gjendja do të fillojë të përmirësohet e veçanërisht në aspektin juridik, ku gjatë fundit të vitit 1968 e deri më 1972 do të ketë ndryshime në amendamente të ndryshme kushtetuese ku Kosova do të përfitojë prej këtyre të fundit. Mirëpo, këto ndryshime kulmin do ta

arrijnë me miratimin e Kushtetutës së vitit 1974. Prandaj, kjo e fundit do të analizohet në mënyrë të detajuar dhe jo vetëm ajo e Federatës në tërësi por edhe kushtetutat e KSA të Kosovës dhe asaj të RS të Serbisë, të cilat sigurisht janë të bazuara në Kushtetutën e Federatës Jugosllave të vitit 1974. Përmes analizimit të këtyre kushtetutave do të paraqiten nene të ndryshme në studim e që më pastaj do të bëhen edhe krahasime të këtyre neneve me njëra tjetrën etj. Në fund të këtij kreu do të paraqitet edhe gjendja socio-ekonomike në Kosovë, investimet e ndryshme, ku janë bërë këto investime dhe arsyet se pse, dhe në fund fare edhe mbi arsyet e ngecjes ekonomike të Kosovës në krahasim me republikat dhe krahinat e tjera të Federatës Jugosllave.

Kreu III: *“Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në rrafshin arsimor-shkencor 1968-1980”*. Gjatë kësaj periudhe përveç zhvillimeve pozitive që pati Kosova në rrafshin juridik ajo pati edhe zhvillime të tjera pozitive në fusha të ndryshme. Njëra prej tyre ishte ajo në rrafshin e arsimit, ku pikërisht gjatë kësaj periudhe, përkatësisht më 1970 themelohet *“Universiteti i Prishtinës”*. Themelimi i tij është një hap tejet i rëndësishëm në zhvillimin e arsimit në Kosovë, jo vetëm atij të lartë, por në përgjithësi. Me themelimin e këtij të fundit do të vendosen kontakte me universitete të ndryshme, si brenda ashtu edhe jashtë Jugosllavisë. Njëri prej këtyre kontakteve të vendosura do të jetë ajo në mes të përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës dhe të atij të Tiranës, me këtë rast palët do të nënshkruajnë memorandume të ndryshme në lidhje me bashkëpunimin në mes tyre, këto memorandume do të sqarohen në studim dhe pastaj do të shtjellohet edhe ecuria e këtyre bashkëpunimeve. Për ardhjen e kuadrove nga Tirana në Prishtinë dhe anasjelltas. Përveç bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe ndihmës që jep shteti shqiptar për arsimin në Kosovë janë studim janë trajtuar edhe konferencat shkencore të cilat janë mbajtur në bashkëpunim dhe me pjesëmarrjen e akademikëve dhe intelektualëve të të dyja vendeve. Për shkak të bashkëpunimeve të shumta në mes të të dy palëve dhe volumit të madh është e vështirë që secilën prej konferencave apo simpoziumeve të ndryshme që janë mbajtur t’iu paraqitet puna e bërë në mënyrë të detajuar. Për këtë arsye fillimisht do të trajtohen në mënyrë sipërfaqësore bashkëpunimet e ndryshme shkencore të cilat janë bërë, ndërsa në fund, në mënyrë të detajuar do të përshkruhet puna që është bërë për nder të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në konferencën kushtuar këtij të fundit në Tiranë dhe simpoziumit të mbajtur për këtë të fundit në Prishtinë.

Kreu IV: *“Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në rrafshin kulturor 1968-1980”*. Një element mjaft i rëndësishëm i studimit është edhe ai i bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në rrafshin kulturor. Gjatë kësaj periudhe, bashkëpunimet në mes të të dyja palëve

në këtë fushë janë të shumta, që nga bashkëpunimet ndërmjet shoqatave të ndryshme, shoqërive kulturore artistike e deri tek sporti etj. Për të mos lënë asnjërin anash me këtë kre synohet që në mënyrë të përgjithshme të paraqiten bashkëpunimet kulturore, duke përdorur burime të ndryshme e veçanërisht ato të materialeve nga arkivi.

Kreu V: “*Demonstratat e vitit 1981 në Kosovë*”. Përmban gjithsej pesë nëntituj, fillimisht fillon me vdekjen e liderit të Jugosllavisë, Josip Broz Tito dhe gjendjen e përgjithshme të cilën e la ai në Jugosllavi, si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik. Do të përshkruhet ceremonia e varrimit të tij dhe reagimi nga Enver Hoxha mbi vdekjen dhe ceremoninë e varrimit të Titos. Pas përshkrimit të situatës së përgjithshme në Jugosllavi studimi do të flasë për shpërthimin e demonstratave të mars-prillit 1981. Arsyet e organizimit të tyre, kërkesat nga ana e demonstruesve, përshkallëzimi i demonstratave, dhuna nga ana e autoriteteve shtetërore, përndjekjen dhe burgosjen e demonstruesve etj. Në nëntitullin e radhes do flitet ndër të tjera edhe për reagimin e shtetit shqiptar ndaj ngjarjeve që ndodhën në Kosovë, qëndrimin e shtetit shqiptar dhe artikujt e ndryshëm që organet e shtetit shqiptar i botuan në gazetën zyrtare të partisë, “*Zëri i Popullit*”. Rëndësi do t’i jepet edhe raportimit që është bërë nga shtypi i huaj në lidhje me demonstratat që u mbajtën në Kosovë, ndërsa në fund fare do të jetë edhe përshkrimi i disa rrethanave të përgjithshme politike në Kosovë që ndodhën pas përfundimit të demonstratave, si shkarkimin e funksionarëve shqiptarë (përkundër qëndrimit të tyre kundër demonstratave), ngritjen e nacionalizmit serb, daljen në skenë të memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve më 1986 dhe sulmet e tjera nacionaliste ndaj Kosovës nga Beogradi që në fund rezultuan me suprimimin e autonomisë më 1989.

Në këtë studim për të arritur në një konkludim janë përdorur metoda të ndryshme shkencore të studimit, siç është metoda e analizës, duke përdorur këtë metodë është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme gjendja në atë kontekst kohor dhe pastaj në mënyrë të veçantë është ndarë mendimi im dhe i autorëve lidhur me një çështje të caktuar. Metodë tjetër e cila është përdorur gjatë punimit të këtij studimi është edhe ajo e heuristikës, ku do të ngrisë pyetje të caktuara dhe të cilave gjatë studimit dhe shtjellimit të çështjes në fjalë do t’u japë përgjigje. Gjatë punimit do të përdoret edhe metoda statistikore, përmes saj do paraqitet me anë të statistikave dhe shifrave zyrtare gjendja ekonomike në Kosovë gjatë kësaj periudhe. Me këtë metodë do të studiohet edhe numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës, numrin e pedagogëve të ardhur në Kosovë nga Shqipëria, si dhe raporte e relacione të ndryshme të tjera lidhur me bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe

Shqipërisë. Janë përdorur edhe metodat e tjera të kërkimit shkencor, sikurse: përshkrimi, hulumtimi dhe krahasimi. Duke përdorur këto metoda do t'iu përgjigjemi pyetjeve të ndryshme të cilat ngriten në lidhje me këtë periudhë dhe për këto ngjarje të lartpërmendura, si ato për:

- “A ndodhën ndryshimet juridike pas vitit 1966 për Kosovën dhe shqiptarët për shkak të simpatisë së Titos ndaj shqiptarëve?”;
- “Kush ishin organizatorët e demonstratave të vitit 1968, roli dhe rëndësia e tyre?”;
- “A i përkrahu Shqipëria demonstratat e vitit 1968, cili ishte qëndrimi i saj?”;
- “Si i paraqiste shtypi vendas dhe i huaj demonstratat e vitit 1968?”;
- “Pse ndodhën ndryshimet juridike-politike në Jugosllavi, pozita e Kosovës në këto ndryshime?”;
- “Bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, roli dhe rëndësia e këtij bashkëpunimi?”;
- “Demonstratat e vitit 1981, organizatorët dhe qëndrimi i funksionarëve shqiptarë dhe jugosllavë?”;
- “Qëndrimi i Shqipërisë ndaj demonstratave të vitit 1981, roli i saj?”;
- “Si raportonte shtypi i huaj për demonstratat e vitit 1981?”, dhe të tjera.

Pas përfundimit të studimit në fund fare në mënyrë të përgjithshme do të jepet edhe një përfundim i shkurtër në lidhje me këto ngjarje.

Punimi mbyllet me burimet arkivore dhe literaturën e gjerë të cilën e kemi shfrytëzuar, revistat shkencore, shtypin e kohës si dhe burime të ndryshme të shfrytëzuara nga interneti.